# DËSHMI ARKIVI

**A-444703**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kurti-opozitës: Ta zgjedhim presidentin, e pafalshme të shkojmë sërish në zgjedhje |
| ADRESA | `https://www.koha.net/lajmet-e-mbremjes-ktv/kurti-opozites-ta-zgjedhim-presidentin-e-pafalshme-te-shkojme-serish-ne-zgjedhje` |
| BURIMI | koha.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 01:37:31 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 17:10:58 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `125e13d034755c82cf8600416430060eed0a63fde2318edffe92b11aa12b6b4e` |
| TEKSTI | `7297ffc58d84e101aba76e75ed8a0076ae176242d97de543b0081b363ebf1d8d` |
| PAMJA | `025e9488ff0006dfba1c599312aec3826354145e5953e4d5c9db589eb974ae2a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `3463625678ff516666f9d747ae0d4e3d0e912d8daef1206d672b8e983855c227` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `339a441950953cdd8a76a2c095ab2238d5bab62fcc252abcef1242a6a5fba2fb` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/3463625678ff516666f9d747ae0d4e3d0e912d8daef1206d672b8e983855c227`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën Kontribuo → Letër lexuesit

LAJMET E MBRËMJES

# Kurti-opozitës: Ta zgjedhim presidentin, e pafalshme të shkojmë sërish në zgjedhje



Foto: Driton Paçarada

Nga: Rrezon Gashi

14 shtator 2026 19:10

Shpërndaje në:

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

**Një ditë pas marrjes së mandatit, Qeveria Kurti 4 ka mbajtur mbledhjen e parë solemne. Kryeministri Albin Kurti ka kërkuar nga partitë opozitare që të mundësojnë zgjedhjen e presidentit, tek i ka akuzuar ato për barrikadim. Në fjalimin e tij, Kurti ka shprehur pritshmërinë për lirimin e katër ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës**

Në mbledhjen e parë të Qeverisë, një ditë pasi mori mandatin, kryeministri Albin Kurti i ka akuzuar partitë opozitare për barrikadim politik dhe u ka bërë thirrje deputetëve që të mundësojnë zgjedhjen e presidentit.

Kurti ka thënë të hënën se, ndonëse arsyetimi për bllokadën politike ka ndryshuar nga viti 2025, sipas tij, qëllimi mbetet i njëjtë.

“Në vitin 2025 shkuam në zgjedhje për shkak të barrikadimit për kuvend e qeveri. Ndërkaq, sivjet më 2026 për shkak të barrikadimit për shkak të presidentit. Sot kur po flasim jemi me Kuvend të konstituuar e Qeveri të zgjedhur. Ndërkaq përpara kemi çështjen e presidentit dhe një marrëveshje politike mes subjekteve Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës për kandidatin për president”, ka thënë Kurti.

Kabineti i Kurtit mori mandatin të dielën nga Kuvendi, i cili u shpall i konstituuar, ndonëse ende nuk ka kryesi të plotë. Konstituimi u përmbyll gjithashtu pas skadimit të afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese.

Në fund të gushtit, LVV-ja dhe LDK-ja prezantuan ish-gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese, Bekim Sejdiu, si kandidat të përbashkët për president.

Por kandidatura e tij nuk ka gjetur mbështetjen e të gjithë deputetëve të LDK-së. Për këtë çështje edhe është ankuar Kurti.

**Arbëri.**
Mustafa: Jam takuar me Kurtin për ta diskutuar platformën time për zhbllokimin institucional

**Futboll.**
Newcastle pëson debakël nga Leedsi

**Futboll.**
Spektakël në Serie A, Interi fiton 5:3 ndaj Udineses

**Futboll.**
Kosova i luan 4 ndeshje brenda 16 ditësh grumbullim

**Arbëri.**
VV-ja pas tërheqjes së Sejdiut: Ishte mundësia që çështja e presidentit të zgjidhej, por u bllokua sërish

**LAJMET E MBRËMJES.**
Mbrojtja kërkon lirimin e Thaçit e katër të tjerëve në rastin për pengim të drejtësisë

Sejdiu njoftoi të hënën për tërheqjen nga kandidatura.

“Para nesh është sfida me qëndrimin e shprehur nga disa deputetë nga radhët e LDK-së, të cilët nuk duan ta zbatojnë marrëveshjen e arritur me mund e përkushtim, pas një procesi negociatash jo të lehta, të autorizuara nga kryesitë përkatëse të partive tona. Jemi kaq zgjidhjes së presidentit, sa që do të ishte e pafalshme të shkojmë sërish në zgjedhje për të ardhur sërish në të njëjtën pikë”, është shprehur ai.

Edhe



**Arbëri** • 13 o. më parë
Kurti i bën thirrje opozitës: Ta zgjedhim presidentin, e pafalshme të shkojmë sërish në zgjedhje

Në fjalimin e tij të parë të mandatit të katërt, kryeministri foli edhe për vendimin e Gjykatës Speciale ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, që do të kumtohet të mërkurën.

“Për ne është gjithçka e qartë, populli i Kosovës, rezistenca dhe lufta jonë ka qenë e drejtë, çlirimtare dhe kundrejt një pushtuesi, i cili kreu krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid. Besojmë e urojmë që edhe verdikti i së mërkurës të jetë në përputhje me këtë të drejtë dhe drejtuesit e UÇK-së të kthehen të lirë në vendin e tyre dhe pranë familjeve”, ka deklaruar Kurti.

Mbledhja e së hënës kishte karakter solemn dhe gjatë saj nuk u bë e ditur marrja e ndonjë vendimi nga Qeveria.

#QEVERIA E KOSOVES #MBLEDHJA E QEVERISË

## Artikuj të ngjashëm



**Arbëri** • 9 sht 2026
Kurti sërish: Konstituimi nuk i shmang zgjedhjet



**Arbëri** • 8 sht 2026
Kurti: Bisedimet për president vazhdojnë, zgjedhjet e reja të paarsyeshme



**Arbëri** • 1 sht 2026
Kurti akuzon 6 deputetët e LDK-së: Duan të shkojmë sërish në zgjedhje, marrëveshja qëndron



**LAJMET E MBRËMJES** • 16 qer 2026
Kurti: Të përfundojë sjellja refuzuese e opozitës

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing
Politika e privatësisë
Kushtet e përdorimit
Udhëzim për përdorimin e IA-së
Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhë tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 / [email protected]




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.